



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE REAL BAILIFF SERVICE

NIPT L71710039A

Nr.2154 Regj
Nr.2182 Prot

Tiranë, më 27.12.2023

URDHËR

“PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE”

Drejtuar: Qendra Kombetare e Biznesit
Adresa: Tirane
Per dijeni: Shoqeria Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike, Nipt K72410014H
Adresa: Blv. “Gjergj Fishta”, ndertesa 88, H 1, Kati i V, Njesia Administrative nr. 7, 1023, Tirane.
Per djeni: Naile Masar Bulku e dtl.05.03.1991, etj
Adresa: Rruga e “Barrikadave”, Pallati “ALBSIG”, kt. 8, Tirane

Unë, Eris Sotiri, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, pranë Zyres Permbarimore Private “REAL BAILIFF SERVICE”, në referim të Titullit Ekzekutiv “Vendimi Nr. 1039, datë 18.11.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korce”, i cili është lene ne fuqi nga “Vendimi Nr.666 (30-2023-4975), date 18.09.2023, i Gjykates se Apelit te Juridiksionit te Pergjithshem Tirane”, kam vënë në ekzekutim këtë Titull, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr.2154, Datë 14.12.2023, kërkesën e kreditorit Naile Masar Bulku e dtl.05.03.1991, etj ndaj debitorit Shoqeria Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike, Nipt K72410014H.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorëve Lajmërimin Nr.2023 Prot, Datë 14.12.2023, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Titullit Ekzekutiv “Vendimi Nr. 1039, datë 18.11.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korce”, i cili është lene ne fuqi nga “Vendimi Nr.666 (30-2023-4975), date 18.09.2023, i Gjykates se Apelit te Juridiksionit te Pergjithshem Tirane” në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOVA:

Debitori Shoqeria Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike, Nipt K72410014H, nuk i është përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të lajmërimit për ekzekutim vullnetar të detyrimit.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestro mbi kreditë e debitorit Shoqeria Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike, Nipt K72410014H, në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Përsa më sipër, në referim të nenit 527 e vijues të K.Pr.Civile, si dhe të neneve 31 pika (b), 32 pikat (c) dhe 46 (paragrafi i 1-rë) të Ligjit Nr. 26/2019 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”, me qëllim ekzekutimin e titullit ekzekutiv,

URDHËROJ:

1. Qendra Kombetare e Biznesit, të vendose sekuestron konservative mbi aktivet e pales debitore Shoqeria Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike, Nipt K72410014H me qëllim mostjetersimin tyre, si dhe mos kryerjen çdo veprimi që do të sillte ndryshime në regjistrin tregetar.
2. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
3. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhëri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.
4. Ky urdhër ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.Civile, kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brenda 5 ditëve nga marja dijeni.

ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE “REAL BAILIFF SERVICE”

PËRMBARUESI GJYQËSOR

ERIS SOTIRI

